Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkreisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

#### 1. QËLLIMI I FURNIZIMIT

##### 1.1. Të përgjithshme

Ky projekt ka si qëllim furnizimin me pajisje rezervë për nevojat e Sektorit të Matjes së Energjisë si matës inteligjent të energjisë, transformator instrumentalë të kombinuar 220 kV, boks hermetik për dy matës, konverter TCP/IP, testues portativ matësi, aparat për matjen e rezistencës së tokës dhe multimetër industrial sipas përshkrimeve teknike të mëposhtme. Furnizimet që do të kryhen nga Kontraktori do të përfshijnë projektin e detajuar, të dhënat teknike të pajisjeve, raportet e testeve rutine të prodhuesit, raportin e testeve të pranimit të fabrikës, paketimin, transportin, sigurimin, transportin në objekt në përputhje me dispozitat e Kontratës dhe për të përmbushur qëllimin e furnizimit. Pajisjet që do të përdoren do të jenë të reja, dhe me cilësi të lartë. Kontraktuesi do të sigurojë besueshmërinë dhe sigurinë e furnizimit të pajisjeve, së bashku me mirëmbajtjen me kosto të ulët kurdoherë që do të jetë e nevojshme. Në këtë specifikim teknik jepen disa kërkesa teknike të përgjithshme dhe specifike për projektimin, prodhimin, lëvrimin, komisionimin e pajisjeve të PM të reja si dhe të atyre rezervë.

##### 1.2. Pajisjet

Pajisjet TM që do të furnizohen janë si më poshtë:

- |   |            |
|---|------------|
| 1. Matës inteligjent energjie 0.5S/5A       | copë 50    |
| 2. Matës inteligjent energjie 0.5S/1A       | copë 30    |
| 3. Matës inteligjent energjie 0.2S/5A       | copë 20    |
| 4. Matës inteligjent energjie 0.2S/1A       | copë 20    |
| 5. Konverter TCP/IP                         | copë 20    |
| 6. Boks hermetik matje                      | copë 25    |
| 7. Stendë Etalon Testues Portativ Matësi    | copë 1     |
| 8. Aparat për matjen e rezistencës së tokës | copë 1     |
| 9. Multimetër industrial                    | copë 2     |
| 10. Modem komunikimi, me kartë SIM GSM/GPRS | copë 50    |
| 11. Vula plastike me logo OST sh.a.         | copë 2,000 |

#### 2. NJËSITË E SISTEMIT TË MATJES

Në të gjitha dokumentet si korrespondenca, skedule teknike, vizatime të projektit dhe shkallët e instrumentave matës duhet të përdoret vetëm sistemi metrik i matjes.

Kontraktori duhet ti përmbahet me rigoroze në mënyrë korrekte Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI) në përputhje me dispozitat ISO 31 dhe ISO 1000.

Më poshtë paraqiten konkretisht:

Sasia	Njësia matëse	Simboli
Gjatësia	Milimetër	mm
Masa	Kilogram	kg
Koha	Sekond	s
Temperatura	Grad Celsius	°C
Diferenca e Temperaturës	Kelvin	K
Rryma elektrike	Amper	A
Sipërfaqja	Metër katror	m <sup>2</sup>
Volumi	Metër-kub Litër	m <sup>3</sup> l



Forca	Newton	N
Presioni	Bar Kilopaskal	bar kPa
Forca mbajtëse	Newton për milimetër katror	N/mm <sup>2</sup>
Shpejtësia	Metër për sekond	m/s
Shpejtësia Rrotulluese	Rrotullime për minutë	rpm
Densiteti	Kilogram për metër kub	kg/m <sup>3</sup>
Forca Përdredhëse	Newton metër	Nm
Fuqia elektrike	Watt	W
Tensioni Sipërfaqësor	Newton për metër	N/m
Frequenca	Hertz	Hz
Ngarkesa Elektrike	Coulon	C
Potenciali Elektrik	Volt	V
Fuqia e fushës Elektrike	Volt për metër	V/m
Kapaciteti Elektrik	Farad	F
Rezistenca Elektrike	Ohm	Ω
Përcjellshmëria	Siemens	S
Fluksi Magnetik	Weber	Wb

### 3. MATERIALET

Të gjitha materialet duhet të jenë të reja dhe me cilësinë më të mirë, të përshtatshme për të punuar në kushte dhe ndryshime të temperaturës dhe presionit të hasur, pa shtrembërim ose dëmtim të panevojshëm ose vendosjen e sforcimeve të panevojshme në ndonjë pjesë. Të gjitha materialet duhet të jenë në përputhje me standardet dhe kodet e miratuara, si dhe trajtimi kimik dhe mekanik duhet të dorëzohen.

Do të lejohet furnizimi i vetëm i pajisjeve të testuara.

Do të pranohen Test Raportet e provave të pajisjeve të ngjashme (për sa i përket madhësisë / masave mekanike dhe elektrike, të dhënave teknike mekanike dhe elektrike) jo më të vjetër se 10 vjet në hapjen e ofertës. Tipet e Test Raporteve do t'i nënshtrohen miratimit të Investitorit. Nëse nuk ka certifikatë prove të tipit të testit, testet do të kryhen me shpenzimet e Kontraktorit.

Për të gjitha pajisjet, test raportet përkatëse të provave në fabrikë duhet të dorëzohen për miratim, përpara dorëzimit të pajisjeve.

### 4. STANDARTET DHE KODET

Furnizimet e pajisjeve do të kryhen duke konsideruar kodet dhe standartet më të fundit, rregulloret e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes si dhe rregulloret ligjore. Standartet IEC dhe praktikat rekomanduese duhet të plotësohen. Të gjitha materialet e pajisjet e furnizuara duhet të plotësojnë kodet teknike të International Organization for Standardization (ISO); rekomandimet IEC për pajisjet elektrike. Është përgjegjësi e Kontraktorit të evidentoj në çdo rast që standartet e kërkuara nga Investitori janë realizuar në mënyrë ekuivalente ose me standart më të lartë.

Të gjitha pajisjet që do të përdoren duhet të inspektohen dhe testohen në përputhje me kërkesat e standarteve më të fundit dhe kërkesat e specifikimeve teknike.

Në të gjitha rrethanat kodet finale të pranueshme duhet të jenë ato më të fundit të publikuara qoftë edhe pas datës së tenderit.

Pajisjet kryesore të specifikuara në specifikimet teknike duhet të projektohen dhe prodhohen në përputhje me edicionin më të fundit të standarteve siç jepen më poshtë:

IEC 52053-61

IEC 61850

IEC 62052-11

Sistemet dhe rrjetet e komunikimit për automatizimin e sistemeve të fuqisë

Pajisje të matjes së energjisë elektrike, kërkesa të përgjithshme

IEC 62053-22	Pajisje të matjes së energjisë elektrike, matës statik për energjinë aktive (klasa 0.2s dhe 0.5s)
IEC 62053-24	Pajisje të matjes së energjisë elektrike, matës statik për energjinë reaktive (klasa 0.5s dhe 1s)
IEC 62052-31	Pajisje të matjes së energjisë elektrike, Pulset e daljes për matësat elektronik dhe elektromekanik
IEC 62056-46	Matësit e energjisë elektrike, shkëmbim të dhënash për leximet e matësave, kontroll i tarifave dhe ngarkesës
IEC 62059-32-1	Testi i qëndrueshmërisë për kushte atmosferike duke aplikuar temperatura të larta dhe të ulëta
2004/22/EC (MID)	Measuring Instruments Directive
IEC 60529	Shkalla e mbrojtjes për bokset (Kodi IP)
IEC 61869-4 :2013	Kërkesa shtesë për transformatorët e kombinuar

## 5. GARANCITË

### 5.1. Garancitë e përgjithshme.

Kontraktori duhet të garantoj:

- Të gjitha materialet janë konform specifikimeve dhe standarteve më të fundit.
- Të gjitha materialet duhet të jenë në përputhje me blerjen e materialeve, skemat, fabrikimin, praktikën e montimit dhe procedurat dhe duhet të jetë konform të gjitha standarteve.
- Të gjitha materialet, pjesët dhe aksesorët të jenë të reja, prodhime të fundit, pa defekte, të cilësisë më të lartë, të përshtatshme për qëllimin ku do të përdoren, me përmasa dhe kapacitete që respektojnë kërkesat e specifikimeve teknike dhe kushtet teknike të përdorimit.

### 1.2.-1. – 1. MATËSI INTELIGJENT I ENERGISË

Matësi i energjisë elektrike kërkohet që të jetë një matës elektronik inteligjent, multifunksional i fuqisë dhe energjisë elektrike aktive - reaktive me matje në katër kuadrante, me hyrje – dalje dixhitale si dhe porta komunikimi me protokolle të caktuara. Matësi duhet të ketë mundësi për ruajtje dhe logim të dhënash në board etj.

### 1.2.-1. – 2. Rregulloret dhe normat

Matësi i energjisë elektrike duhet të plotësoj kërkesat sipas standardeve IEC 62052-11, IEC 62053-22, IEC 62053-24, IEC 62052-31 dhe IEC 62059-32-1. Matësi i energjisë elektrike duhet të përputhet me direktivën 2004/22/EC (MID) të instrumentave matës të energjisë elektrike, pasi është kusht ligjor, pra i domosdoshëm për njohjen dhe kalibrimin e matësit të energjisë elektrike. Prodhuesi i matësive të energjisë elektrike duhet të sigurojë certifikatat ISO 9001:2015, ISO 27001:2013 dhe ISO 17025:2017

### 1.2.-1. – 3. Specifikimet teknike kryesore

Matësi i energjisë elektrike do të përdoret për matjen e energjisë aktive dhe reaktive në katër kuadrante në sistemin tre-fazor të energjisë AC me skemë lidhje me 3 faza me 3 përcjellësa, dhe 3 faza me 4 përcjellësa për matjen e energjisë elektrike me transformator rryme e tensioni dhe të kombinuar. Më poshtë jepen disa karakteristika kryesore të matësit inteligjent të energjisë elektrike.

- Tensioni: 57.7-240 V L-N.
- Frekuenca: 50 Hz.
- Rryma nominale:  $I_n = 1A$  dhe  $5A$
- Ndjeshmëria 0.15%  $I_n$ ;
- Qëndrueshmëria nga mbingarkesa për kohë të gjatë 6 A për  $I_n=1A$  dhe 20 A për  $I_n=5A$ .
- Temperatura e punës: - 40 ° C deri + 70 ° C.
- Testet e temperaturës sipas IEC 62052-11 seksioni 6.3.3
- Lagështia relative: 95%.

- 
- Shkalla e izolimit: IP54.
  - Testet sipas IEC 60068-2-11

#### **1.2.-1. – 4. Konsumi në qarqet e tensionit dhe rrymës**

Konsumi në qarqet e tensionit për tension nominal: më pak se 10VA/fazë për tension nominal sipas IEC 52053-61. Konsumi në qarqet e rrymës për rrymë nominale: më pak se 0.5 VA/fazë për rrymë nominale.

#### **1.2.-1. – 5. Saktësia e matjes**

Klasa e saktësisë 0.2S dhe 0.5S për energjinë aktive dhe klasa 0.5S për energjinë reaktive sipas IEC 62053-24.

#### **1.2.-1. – 6. Kërkesat mekanike**

Matësi i energjisë elektrike duhet të projektohet dhe ndërtohet në mënyrë të tillë për të shmangur çdo rrezik në përdorim normal dhe nën kushte normale, për të siguruar sidomos: sigurinë personale kundër goditjes elektrike, sigurinë personale kundër efekteve të temperaturës ekstreme, mbrojtjen kundër përhapjes së zjarrit, mbrojtjen kundër depërtimit të objekteve të ngurta, pluhuri dhe uji. Matësi i energjisë elektrike duhet të jetë kompakt dhe i besueshëm në dizajn, i lehtë për t'u transportuar dhe imun ndaj dridhjeve dhe goditjeve të përfshira në transport dhe në punim. Të gjitha pjesët të cilat i nënshtrohen korrozionit në kushte normale të punës duhet të mbrohen në mënyrë efektive. Lidhjet elektrike në matësin e energjisë elektrike duhet të jenë rezistente ndaj ndërhyrjeve. Matësi i energjisë elektrike duhet të ketë mundësi vulosje në mënyrë të tillë që pjesët e brendshme të tij të jenë të pa aksesueshëm dhe tentativa për të hapur matësin do rezultojnë në dëmim të dukshëm në kapakun e tij.

#### **1.2.-1. – 7. Blloku i terminaleve dhe kapaku**

Terminalet të ketë të grupuara në një bllok terminali që ka veti të përshtatshme izolimi elektrik dhe mekanik. Blloku i terminaleve duhet të jetë prej materiali jo-higroskopik të një cilësie shumë të mirë dhe rezistent ndaj zjarrit. Terminalet në bllokun e terminaleve duhet të kenë gjatësi të mjaftueshme në mënyrë që të bëjnë shtrëngimin (kapjen) e duhur të përcjellësit me ndihmën e dy vidave. Vidat nuk duhet të kenë skaje të mprehta në fundin e fijeve. Vrimat në materialin izolues duhet të jenë të madhësisë së mjaftueshme për të akomoduar edhe izolimin e përcjellësit. Kapaku i terminalit duhet të jetë prej plastike inxhinierike me trashësi minimale 2.5 mm. Duhet të jetë e tipit të zgjatur që mbulon plotësisht bllokun e terminalit dhe vrimat e fiksimit.

#### **1.2.-1. – 8. Lidhja e gabuar e fazave**

Matësi i energjisë elektrike duhet të funksionojë në rast të mungesës së një ose dy fazë. Matësi i energjisë elektrike duhet të funksionojë normalisht, kur:

- Një ose dy faza mungojnë, por neutri dhe një ose dy faza janë të lidhura;
- Neutri mungon, por dy ose tre faza janë të lidhura,
- Neutri dhe një fazë janë të lidhura në të kundërt (ngatërruar).

#### **1.2.-1. – 9. Targeta**

Një targetë e përshtatshme duhet të sigurohet brenda në pjesën e përparme të matësit të energjisë elektrike, duke treguar të dhënat e mëposhtme:

- Emri i Prodhuesit, vendi dhe viti i prodhimit;
- Tipi;
- Numri i serisë;
- Tensioni nominal;
- Rryma nominale dhe maksimale;
- Frekuenca;
- Konstantja e Matësit;
- Klasa e saktësisë;
- Tipi i i markës së aprovuar;
- Barkod;
- Standartin MID (M);
- Skema e lidhjes (mund të jetë në kapakun e terminaleve).

### **1.2.-1. – 10. Ekрани**

Ekрани i matësit të energjisë elektrike duhet të jetë i tipit LCD. Minimalisht duhet të jenë në dispozicion dy mënyra të shfaqjes së ekranit: Një shfaqje do të jetë Normale ose Automatikë, Mënyra tjetër do të jetë mënyra manuale e cila duhet të shfaqë të gjithë parametrat dhe duhet të ketë prioritet për të shfaqur fuqinë e çastit, tensionin, rrymën dhe frekuencën.

Ekрани i matësit të energjisë elektrike duhet të tregojë:

- Drejtimi i fluksit të energjisë elektrike;
- Tregues i fazave të tensionit;
- Tregues i tarifës aktuale.

Matësi i energjisë elektrike duhet të ketë buton shtypje (s) për të mbështetur leximin manual të matësit. Ekрани duhet të jetë me të paktën 16 shifra për konsumin e energjisë (numri i plotë dhe numrat pas presjes dhjetore janë 14 +2) dhe të paktën 16 shifra për kërkesën (numri i shifrave pas presjes dhjetore duhet të jetë të paktën 2). Vlerat që shfaqen në ekran janë të programueshme. Matësi duhet të ketë një output të aksesueshme nga përpara dhe të jetë në gjendje të monitorohet me pajisje të përshtatshme testimi. Treguesi i funksionimit duhet të jetë i dukshëm nga përpara. Output i testit duhet të sigurohet në formën e një LED për energjinë aktive, reaktive me sigurimin e zgjedhjes së parametrin që testohet. Ekрани duhet të shfaqë direkt vlerat e matura pa qenë e nevojshme të aplikohen faktorë shumëzues të jashtëm.

### **1.2.-1. – 11. Numri i tarifave**

Matësi i energjisë elektrike duhet të ketë mundësi për ruajtjen e vlerave të matura në të paktën 8 (tetë) regjistra të tarifave. Numri i tarifave duhet të jetë i programueshëm.

### **1.2.-1. – 12. Impulse dalëse**

Matësi i energjisë elektrike duhet të ketë impulset dalës si më poshtë:

- të paktën një (1) impuls optik dalës.
- të paktën një (1) impuls elektrik dalës.

### **1.2.-1. – 13. Konstantja e matësit**

Konstantet e matësit të energjisë elektrike kërkohen si më poshtë:

- $\geq 1000$  imp / kWh për daljen optike të impulseve,
- $\geq 1000$  imp / kWh për daljen elektrike të impulseve.

### **1.2.-1. – 14. Funksionet e matësit**

Matësi i energjisë elektrike duhet të ketë mundësi për matjen, ruajtjen dhe shfaqjen e vlerës absolute të energjisë aktive sipas planit tarifor brenda klasës së saktësisë. Të ofroj mundësinë e kompensimit të humbjeve në linje dhe transformator. Të masë koeficientin e ngarkesës, frekuencën dhe këndet e fazave.

### **1.2.-1. – 15. Fuqinë mesatare maksimale**

Matësi i energjisë elektrike duhet të ketë mundësi për matjen, ruajtjen dhe shfaqjen e fuqisë mesatare maksimale eksport/import sipas planit tarifor brenda klasës së saktësisë.

### **1.2.-1. – 16. Vlerat e çastit**

Matësi i energjisë elektrike duhet të ketë mundësi për matjen dhe shfaqjen të:

- Fuqisë së çastit;
- Tensionin e çastit për secilën fazë;
- Rrymën e çastit për secilën fazë;
- Frekuenca e çastit;
- Vlerën maksimale të rrymës;
- Matësi duhet të ketë mundësi për matjen, ruajtjen dhe shfaqjen e vlerave maksimale të rrymës duke përdorur anketime apo profilet;
- Matësi duhet të ketë mundësi për regjistrimin e mungesës së tensionit në një prej terminaleve.
- Matësi gjithashtu mund të konfigurohet për të nxitur një alarm për në sistemin qendror nëse një fazë mungon.

---

### **1.2.-1. – 17. Ora e brëndshme**

Matësi i energjisë elektrike duhet të ketë orën dhe kalendarin të integruar, me një devijim ditor të orës së brëndshme <0.5s. Të ofroj mundësinë e programimit të formatit të datës dhe orës që do të shfaqen në matës sipas kërkesës. Matësi duhet të ofroj mundësinë e sinkronizimit të orës në distancë nëpërmjet programit të menaxhimit në platformën qendrore të të dhënave në sistemin e matjes së energjisë dhe gjithashtu në mënyrë lokale. Të gjitha ndryshimet e orës duhet të regjistrohen në memorien e matësit. Ora e brëndshme në kohë reale ofron të gjitha sinjalet kohore që janë të nevojshme për funksionimin e matësit në lidhje me treguesin maksimal të kërkesës, menaxhimin e tarifave dhe regjistrimin e ngjarjeve.

### **1.2.-1. – 18. Bateria e matësit**

Matësi i energjisë elektrike duhet të jetë i pajisur me bateri të jashtme të instaluar në të. Kapaciteti i fuqisë së baterisë duhet të zgjasë së paku 10 vjet dhe kohëzgjatja e jetës mbi 10 vjet.

### **1.2.-1. – 19. Menaxhimi i tarifave**

Matësi i energjisë elektrike duhet të ketë te paktën deri në 8 tarifa të menaxhueshme; të paktën deri në 32 regjistra të ndarë import dhe eksport. Menaxhim të tarifave në intervale ditore, javore, mujore, vjetore gjithashtu dhe ditë të veçanta.

### **1.2.-1. – 20. Mbrojtja e integritetit të matësit**

Matësi i energjisë elektrike duhet të kenë mundësi për zbulimin e fushës së fortë magnetike në afërsi të tij (fushë magnetike e jashtme me një intensitet më të lartë se sa është përcaktuar në IEC 62053-22 dhe IEC 62052-11). Këto ngjarje duhet të regjistrohen në memorien e matësit.

### **1.2.-1. – 21. Të dhënat qendrore**

Matësi i energjisë elektrike duhet të ketë të dhëna qendrore të cilat janë ruajtur në regjistër të veçantë dhe që nuk mund të ndryshohen.

### **1.2.-1. – 22. Profilet e ngarkesës dhe ruajtja e të dhënave të faturimit**

Matësi i energjisë elektrike duhet të jetë në gjendje të rregjistroj profilet e Energjisë Aktive, Energjisë Reaktive, Energjinë e Plotë, Fuqinë Aktive, Fuqinë e Plotë, Rrymën dhe Tensionin për çdo fazë, koeficientin e fuqisë. Çdo e dhënë rregjistrohet së bashku me datën dhe orën e matjes. Matësi i energjisë elektrike duhet të ketë mundësi për matjen dhe ruajtjen në të paktën 4 regjistra, mesataren e energjisë deri në 1 (një) minutë (të profilit të ngarkesës). Matësi duhet të ketë mundësi për ndryshimin e periudhës së integritetit. Matësi duhet të ketë mundësi për ruajtjen e fuqisë mesatare 15-minuta në periudhë jo më të shkurtër se një vit. Përmbajtja në këtë listë duhet të jetë e programueshme. Matësi së bashku me profilet e ngarkesës, duhet të jetë gjithashtu në gjendje të regjistrojë nivelet minimale, mesatare dhe maksimale të nivelit të tensionit, si dhe frekuencën në periudhat 15 minuta. Matësi duhet të kenë mundësi për të ruajtur të dhënat e faturimit në periudhë jo më të shkurtër se 13 periudha faturimi (të energjisë dhe të fuqisë mesatare maksimale). Periudha bazë e faturimit është një muaj. Pas kalimit të 13 periudhave të faturimit, kur fillojnë cikle të reja, memorja e matësit duhet të siguroj hapësirë për një bllok të ri të kujtesës, duke fshirë rregjistrin e parë (me të vjetrin) në rradhën e rregjistrave. Përmbajtja në këtë listë duhet të jetë e programueshme.

### **1.2.-1. – 23. Monitorimi i cilësisë së rrjetit**

Matësi i energjisë elektrike duhet të siguroj monitorimin e cilësisë sipas standartit IEC 61000-4-30 klasa S. Kjo klasë ka të bëjë me matjen bazike të monitorimit të cilësisë për të rregjistruar të dhënat dhe eventet në mënyrë sasiore. Matësi i energjisë elektrike duhet të masë:

- Frekuencën
- Madhësinë e tensionit
- Disbalancën e tensionit
- Harmonikat e tensionit
- Kërcimet e tensionit (Sag and Swell)
- Ndërprerjen e tensionit

Matësi i energjisë elektrike duhet të ketë mundësi për përcaktimin e pragjeve të vlerave të tensionit për çdo fazë. Matësi duhet të ketë mundësi për ruajtjen e të paktën 1000 rregjistrimeve. Përmbajtja në këtë listë duhet të jetë e programueshme.

### 1.2.-1. – 24. Komunikimi

Matësi i energjisë elektrike duhet të ofroj lidhje mundësi komunikimi mes matësit elektronik dhe pajisjeve të ndryshme (konvertues protokollit, koncentratorit etj).

- **Ndërfaqet e komunikimit**

Matësi i energjisë elektrike duhet të përmbajë tre ndërfaqe të komunikimit të pavarura:

1. Matësi duhet të siguroj ndërfaqe komunikimi optike;
2. Ndërfaqja e dytë e komunikimit do të jetë ndërfaqe RS485. Kjo ndërfaqe duhet të jetë aktive dhe duhet të jetë e izoluar. Kjo ndërfaqe do të përdoret për lidhjen me matësin në kaskadë.
3. Ndërfaqja e tretë e komunikimit me modem do të jetë ndërfaqe RS232 dhe Ethernet.  
Porta RS232 mund të pranojë module PLC, GSM/GPRS/3G.

Modulet e komunikimit duhet të integrohen në mënyrë modulare në matës, për shembull nën kapakun e bllokut të terminaleve. Duhet të sigurohet një modem i integruar GSM/GPRS i cili ushqehet me energji nga matësi dhe të përfshihet nën kapakun e terminaleve.

- **Protokolli i komunikimit**

Matësi i energjisë elektrike duhet të suportoj protokollin e komunikimit DLMS/COSEM (IEC 62056-46), MODBUS(RTU). Matësi i energjisë elektrike duhet të plotësoj të gjithë specifikimet teknike të mësipërme ku më kryesorët janë të regjistruar të dhënat e kërkuara dhe të jetë i aftë ti transmetoj ato në drejtim të platformës së menaxhimit të të dhënave në sistemin e matjes së energjisë të OST sh.a, përshtatur me protokollin e komunikimit me sistemin AMR/AMI të OST sh.a. Matësi duhet të suportoj këtë protokoll në të gjitha ndërfaqet e komunikimit. Të suportoj upgrade dhe konfigurime lokale dhe në distancë. Të suportoj protokollin e nënstacionit IEC 61850 që mundëson automatizimin e fuqishëm të nënstacionit dhe aplikimet e pajisjeve në kohë reale.

### 1.2.-1. – 25. TABELA E TË DHËNAVE TEKNIKE

SPECIFIKIMET TEKNIKE			
MATËSI INTELIGJENT I ENERGJISË			
NR.	PËRSHKRIMI	KËRKOHET	Ofrohet
<b>KËRKESA TË PËRGJITHSHME</b>			
1	Emri i prodhuesit		
2	Vëndi i prodhimit		
3	Tipi		
4	Çertifikata ISO	ISO 9001:2008,	
5	Tensioni nominal	57.7 - 240 V	
6	Frekuenca nominale	50 Hz	
7	Rryma nominale	1A dhe 5 A	
8	Rryma e ndjeshmërisë	Më e vogël se 0.15% In	
9	Klasa e saktësisë për energjinë aktive	Klasa 0.2S dhe 0.5S	
10	Klasa e saktësisë për energjinë reaktive	Klasa 0.5S	
11	Temperaturat e punës dhe të magazinimit	Funksionimi -25 deri +60°C Magazinimi -25 to +80°C	
12	Lagështia relative	0 to 95%, jo e kondensueshme	
13	Klasa e mbrojtjes e karkasës	IP54	
14	Konsumi në qarkun e tensionit për tension nominal	Më pak se 10 VA dhe 2 W për fazë	
15	Konsumi në qarkun e rrymës për rrymën nominale	Më pak se 0.5 VA për fazë	

16	Madhësitë e matura	Import/Export Wh, varh dhe Vah Vlerat absolute Wh, varh dhe Vah Matje në 4 kuadrante Wh, varh dhe VAh Fuqia A, B, C ose Total Fuqia: W, var, VA Vlera RMS e çastit për tensionin (3 fazat) Vlera RMS e çasti për rrymën (3 fazat) Rendimenti Frekuenca Këndi fazor	
17	Sistemet e matjes	3 fazor me 3 përcjellës (2 elementë) 3 fazor me 4 përcjellës (3 elementë)	
18	Përshtatshmëria elektromagnetike dhe imuniteti nga zhurmat e tjera	Në përputhje me IEC 62052-11	
19	Përmasat	Max: 270mm (L) 180 mm (W) 100mm (D)	
<b>II KOMUNIKIMI</b>			
1	Me mundësi për komunikim me Port RS-485.	Po	
2	Me mundësi për komunikim me Port RS-232.	Po	
3	Portë Ethernet Rj45 për rrjet LAN	Po	
4	Realizimi i sinkronizimit dhe konfigurimit nga Sistemi i menaxhimit?	Po	
5	I pajisur me ndërfaqe optike?	Po	
6	Me mundësi për sinkronizim dhe për menaxhim të kohës?	Po	
7	Me mundësi për ri-lexim në rast të dështimit të komunikimit në distancë?	Po	
8	Me mundësi leximi lokal me PC, nëpërmjet ndërfaqes optike?	Po	
9	Modem i brendshëm (i resetueshëm automatikisht)	Po	
10	Modem ndërfaqe GSM/GPRS	Po	
10	I përshtatshëm për protokollin e komunikimit DLMS/COSEM (IEC 62056-46)	Po	
11	Modbus RTU slave nëpërmjet portave seriale	Po	
12	Modbus UDP/IP over PPP/GPRS	Po	
13	Transferim të dhënash midis internetit dhe portës RS-485.	Po	
<b>III HYRJET DHE DALJET</b>			
1	Dalje testi	Po	
2	Tregim i gjëndjes së hyrjeve	Po	
3	Dalje që konfigurohen me anë të SW	Po	

4	Daljet të impulseve të energjisë transmetohen proporcionalisht	Po	
<b>IV REGJISTRAT</b>			
1	Adresim i regjistrave	Po	
2	Numri i regjistrave për energjinë	I programueshëm	
3	Numri i regjistrave për daljet	I programueshëm	
4	Tipi i afishuesit (ekranit)	I programueshëm	
5	A afishon matësi: Drejtimin e fluksit të energjisë? Tregimin e tensioneve të fazave? Tregimin e tarifës aktuale?	Po Po Po	
6	A është i pajisur matësi me buton(a) për të realizuar leximin manual?	Po	
7	A janë të programueshme madhësit që afishohen në ekran?	Po	
8	A është e programueshme frekuenca e elementeve që shfaqen në ekran?	Po	
9	A është kapaciteti i baterisë për 10 vjet dhe jetegjatësia e pritëshme është më e madhe se 10 vjet?	Po	
10	A siguron akses në mënyrën e konfigurimit të regjistrave?	Po	
11	A siguron vendosjen e kohës bazë me anë të SW dhe manualisht?	Po	
12	A siguron leximin e profileve?	Po	
13	A ka matësi të dhëna kryesore të ruajtura në një regjistër të përcaktuar dhe të cilat mund të ndryshohen?	Po	
14	A regjistron matësi profilin e ngarkesës për energjinë aktive?	Po	
15	A ka matësi mundësi për matje dhe për ruajtjen e rezultateve, në të paktën 4 regjistra, energjinë mesatare për 15 minuta?	Po	
16	A ka matësi mundësi për ndryshimin e periudës së integrimit?	Po	
<b>V PROFILET</b>			
1	Perioda e matjes	E programueshme	
2	Mundësi për ta shfaqur në mënyrë të vazhdueshme në ekran	Po	
3	A i ruan vlerat e matura?	Po	
4	A ka matësi mundësi për të lexuar, ruajtur dhe për të afishuar energjinë aktive absolute në përputhje me planin e tarifave brenda klasës së saktësisë?	Po	
5	A ka matësi mundësi për të lexuar, ruajtur dhe për të afishuar energjinë aktive maksimale të importuar në përputhje me	Po	




	planin e tarifave brenda klasës së saktësisë?		
6	A ka matësi mundësi për matje dhe afishim të fuqisë së çastit?	Po	
7	A ka matësi mundësi për matje dhe afishim të tensioneve të çastit për secilën fazë?	Po	
8	A ka matësi mundësi për matje dhe afishim të rrymave të çastit për secilën fazë?	Po	
9	A ka matësi mundësi për për regjistrimin e mungesës së tensionit të fazës në një nga terminalet e tij?	Po	
10	A punon matësi në mënyrë korrekte në rast të mungesës së një ose dy fazave?	Po	
11	A punon matësi në mënyrë korrekte në rast në rast se një ose dy faza mungojnë dhe neutri dhe një ose dy faza janë të lidhura?	Po	
12	A punon matësi në mënyrë korrekte në rast se neutri mungon por dy ose tre fazat janë të lidhura?	Po	
13	A punon matësi në mënyrë korrekte në rast se neutri dhe njëra fazë janë lidhur në mënyrë inverse (kanë ndërruar vendet)?	Po	
14	A e ruan ora e brendëshme kohën e saktë dhe datën në se ndërpritet energjia për të paktën dy vjet?	Po	
<b>VI TARIFAT</b>			
1	Numri i tarifave	8	
2	Sinkronizimi i kohës bazë	Po	
3	Ndryshimi automatik nga ora dimrore në atë verore	Po	
4	Ruajtje të dhënash automatike në kohë reale (Real time backup)	Po	
5	Matësi duhet të ketë mundësi për dy mënyra menaxhimi të tarifave. Burimi i ndryshimit të tarifave mund të jetë i brendshëm ose i jashtëm	Po	
6	Tipi i menaxhimit të tarifave është i programueshëm.	Po	
<b>VII TË TJERA</b>			
1	Jetëgjatësi minimale e kërkuar për pajisjet	10 vjet	
2	Skema e instalimit dhe e përskrimit të morseterisë nën mbulesën e matesit	Po	
3	Skema e lidhjes së morseterisë e vendosur në pjesën e brendëshme të kapakut të morseterisë	Po	

4	Konstantet e matësit të energjisë për impulsin optik	Po	
5	Konstantet e matësit të energjisë për impulsin elektrik	Po	
6	A tregon informacione suplementare në ekran?	Po	
7	Regjistrues i ngjarjeve	Po	
8	Jetgjatësia teknike	10 vjet	
9	Test raportet e tipit	Po	
10	Çertifikata e lëshuar nga një autoritet i pavaruar çertifikimi	Po	

## 1.2. - 5. KONVERTERI TCP/IP

Platforma e menaxhimit të të dhënave në sistemin e matjes së energjisë të OST sh.a, përshtatur me protokollin e komunikimit me sistemin AMR/AMI të OST sh.a. komunikon me matësat nëpërmjet rrjetit GSM/GPRS dhe nëpërmjet rrjetit LAN për të cilën është ndërtuar infrastruktura në çdo pikë të matjes së energjisë elektrike për t'u lidhur me anë të rrjetit të telekomunikacionit të OST sh.a. nëpërmjet OPGW. Në Figurën e mëposhtme jepet skema e lidhjes së pikave të matjes me anë të rrjetit të telekomunikacionit të OST sh.a., për lidhjen e nënstacioneve me Qendrën e Menaxhimit të Energjisë (QME).



Për komunikim nëpërmjet sistemit LAN ofertuesi duhet të furnizoj konverter TCP/IP.

Karakteristikat kryesore të konverterit:

- Të suportoj katër tipe lidhje : TCP Server, UDP Server, TCP Client, UDP Client
- DHCP (Dynamic Host Configuration Protocol) Client merr konfigurimin e TCP/IP nga një server i centralizuar DHCP.
- Dynamic DNS, nga e cila mund të kemi një Hostname statik për një adresë IP dinamike, duke lejuar që Host të jetë i aksesueshëm nga vende të ndryshme në internet.
- Menaxhim të plot të network-ut nëpërmjet Web-it. Kjo duhet të lejoj që konverteri mund të menaxhohet nëpërmjet çdo platforme shfletuese në internet (si Internet Explorer ose Netscape). Gjithashtu të ofroj mundësinë që firmware të kryhet nëpërmjet Web.
- Konfigurim të Backup dhe Restore, të mundësoj krijimin e një konfigurimi në formë dokumenti (backup system configuration file) të cilin mund ta përdorësh (restore) për parametrizimin e konverterave të tjerë.

## 1.2. - 6. BOKSI HERMETIK I MATJES

Boksi i hermetik i matjes (BM) duhet të projektohet dhe prodhohet për instalime të jashtme, me klasë mbrojtje IP 65, në konformitet me standartin IEC 60529. BM duhet të prodhohet me lllamarinë çeliku me trashësi 1.5 mm dhe duhet të ketë dy dritare transparente prej xhami të temperuar, me trashësi 2-3 mm. Dritaret duhet të kenë dimensione të mjaftueshme që të lejojnë leximin e matësit të energjisë elektrike. Brenda BM duhet të vendoset një pllakë metalike e galvanizuar me trashësi 2mm, për montimin e matësive dhe aksesorëve të lidhur me të si: dy blloqe terminalesh testimi me funksion për lidhjen, shuntimin dhe testimin e matësit dhe transformatorëve instrumental (nga një për çdo matës); termostati së bashku me rezistencën antikondesim të lidhura në tension 110-220V AC/DC, nëpërmjet një automati dy-polar të vendosur në BM; dy automate katër-polar së bashku me kablmet për lidhjen e matësit nëpërmjet blloqeve të terminaleve me pësjtjellat sekondare të transformatorit të tensionit; dy automate dy-polar së bashku me kablmet për lidhjen e matësit me tension suplementar 110-220 AC/DC.

BM duhet të lëvrohet i kompletuar me të gjithë aksesorët e montuara si dhe të jenë bërë kablmet e marketuara për lidhjen midis tyre si dhe me matësin. Dera e BM duhet të jetë një derë tip e varur dhe e paisur me bravë mbyllëse me 2 çelësa. Po kështu BM duhet të ketë mundësinë për të vendosur në të vula plastike me qëllim për të identifikuar dhe ndaluar hapjen e paautorizuar të derës. Po kështu. Brënda BM duhet të ketë 3 bullona për lidhjen e tokëzimit, ku njëri nga ta duhet të jetë në pjesën e brëndshme të derës. BM duhet të jetë i pajisur me dy rekordera  $\geq \phi 50\text{mm}$  në mënyrë që hyrja e kablmeve të jetë e ndarë për secilin matës, si dhe një rekoder për futjen e përcjellësit të tokëzimit. Sipërfaqja e BM duhet të jetë e mbrojtur nga korrozioni dhe e lyer me bojë gri të hapur. Dimensionet orientuese të BM duhet të jenë jo më pak se 700x600x200 mm (WxHxD).

## 1.2. - 7. STENDË ETALON TESTUES PORTATIV MATËSI

Ky specifikim mbulon projektimin, prodhimin, testimin dhe furnizimin e Testuesit Portativ të Matësit (TPM) me burime rryme dhe tensioni të integruara me klasë saktësie 0.1 në rrymë direkte dhe kabllot e nevojshme me aksesorët e tjerë për funksionim të duhur për testimin e matësit trefazor për klasë 0.2, 0.5, 1.0 të instaluar në terren si dhe në laborator.

### 1.2.-7. – 1. Aplikimi

Funksioni i TPM duhet të jetë i përshtatshëm të gjeneroj tension deri në 300 V, rrymë deri në 12 A dhe të mas paramentrat e sistemit. Ai duhet të verifikoj saktësinë e matësit trefazor në laborator si dhe në terren. TPM do të përdoret gjerësisht në terren dhe laborator për verifikimin e saktësisë të të gjithë matësive që lidhen direkt ose me transformatorë rryme me ndihmën e një burimi të integruar të energjisë.

### 1.2.-7. – 2. Burimi i tensionit

TPM duhet të jetë i pajisur me një burim tensioni shtesë për t'u energjizuar të një rangu 85 deri 265 V, dhe frekuence 47 deri 63 Hz.

### 1.2.-7. – 3. Burimet

#### Tensioni:

Diapazoni:	20V deri ne 500V (P-N)
Parametri i saktësisë:	Më mirë se 0.2%
Deformim:	< 0.5%
Fuqia:	30VA
Harmonikat:	deri në 40-të
Amplituda e harmonikave:	Maks. 40%    2-të deri në 10-të Maks. 10%    11-të deri në 40-të

#### Rryma:

Diapazoni:	1mA deri në 120A për çdo fazë
Parametri i saktësisë:	Më mirë se 0.2%

Deformimi:	<0.5%
Fuqia:	60VA
Harmonikat:	deri në 40-të
Amplituda e harmonikave:	Maks. 40%      2-të deri në 10-të Maks. 10%      11-të deri në 40-të

#### **Këndi Fazor:**

Diapazoni:	0° deri 359.99°
Saktësia:	Më mirë se 0.1° (për ngarkesë simetrike)
Rezolucioni:	0.01°

#### **Frekuenca:**

Diapazoni:	47 deri 63 Hz
Saktësia:	Më mirë se 0.01 Hz
Rezolucioni:	0.01 Hz

#### **1.2.-7. – 4. Kushtet (atmosferike) e punës**

Pajisja që do furnizohet sipas këtij specifikimi duhet të jetë në gjendje të kryej dhe të ruaj saktësinë e kërkuar për funksionim të kënaqshëm në të gjitha kushtet atmosferike të përmendura si më poshtë:

- Temperatura e punës: -10° deri ne +50°C
- Temperatura e magazinimit: -15° deri ne +65°C
- Lagështia: Maks. 95%

Kërkesa të përgjithshme:

- a. Të gjitha materialet, komponentet e fuqisë dhe elektronike të përdorura në prodhimin e pajisjes duhet të jenë të cilësisë më të mirë për të siguruar besueshmëri të lart, jetëgjatësi dhe saktësi të qëndrueshme.
- b. TPM duhet të jetë me konstruktion të fortë, të lehtë dhe duhet të jetë portativ dhe praktik.
- c. Pajisja duhet të ketë lehtësi për të ndërruar kapëset (darët) në CT nga pajisja në pajisje pa ndikuar në saktësinë e përgjithshme.
- d. Së bashku me TPM duhet të furnizohet një grup kabllorsh rryme dhe tensioni.
- e. TPM duhet të ketë kalkulator gabimi të inkorporuar, i cili do të ketë aftësinë për të llogaritur gabimin në përqindje të matësit që do të testohet duke ushqyer konstanten dhe numrin e pulseve për të cilin matësi po testohet.
- f. Pajisja duhet të ketë ekran të integruar LCD të lexueshëm me butona komandimi në pjesën e përparme të saj për funksionimin dhe integritet shumë të mirë të pajisjes.

#### **1.2.-7. – 5. Mënyrat e matjes**

Pajisja e ofruar duhet të ketë mënyrat e matjes në vijim për të testuar matësin për tipet në vijim.

- Një fazorë me dy përcjellësa aktivë dhe reaktivë
- Tre fazorë me tre përcjellësa aktivë dhe reaktivë
- Tre fazorë me katër përcjellësa aktivë, reaktivë dhe e plotë.

#### **1.2.-7. – 6. Kërkesat e saktësisë**

Klasa e saktësisë e pajisjes së ofruar për fuqinë aktive dhe reaktive, matja e energjisë duhet të jetë 0.1% për diapazon rryme nga 1mA deri në 12A për matjen me lidhje direkte.

#### **1.2.-7. – 7. Ekрани**

TPM e ofruar duhet të ketë ekran të lexueshëm me ndriçim grafik me ngjyra minimale “8”. Ekranet jashtme nuk pranohen.

TPM duhet të shfaqë parametrat e sistemit si në vijim:

- Tension Fazë-Fazë dhe Fazë-Neutër për çdo fazë
- Pajisja duhet të ketë mundësinë për të matur dhe shfaqur fuqinë aktive, reaktive dhe të plotë (së bashku me drejtimin) për çdo fazë. Pajisja duhet të ketë mundësinë për të shfaqur harmonikat deri në rendin e 40-të në formë tabelore, formë lineare, grafik me kolona.
- Deformimet e harmonikave në çdo fazë dhe deformimi total.

- Rrymën e fazës për çdo fazë
- Këndin e fazës ndërmjet tensioneve
- Këndin e fazës ndërmjet tensionit dhe rrymës
- Fuqinë aktive, reaktive dhe të plotë për çdo fazë dhe Total.
- Koeficientin e fuqisë për çdo fazë dhe Total
- Frekuencën
- Gabimin në Përqindje

Pajisja e ofruar duhet të mundësoj për të parë/monitoruar parametrat e sistemit, diagramën vektoriale dhe harmonikat gjatë kryerjes së testimit.

#### 1.2.-7. – 8. TABELA E TË DHËNAVE TEKNIKE

<b>SPECIFIKIMET TEKNIKE</b>			
<b>PAJISJE TESTUESE PORTATIVE E MATËSIT TË ENERGJISË</b>			
<b>PËRSHKRIMI</b>	<b>Njësia</b>	<b>KËRKOHET</b>	<b>Ofrohet</b>
<b>Te pergjithshme</b>			
Gama e tensionit	V	85 deri 265	
Gama e frekuencës	Hz	47 deri 63	
Konsumi	VA	22	
Gama e temperaturës, operimi	° C	(-10 deri + 50	
Gama e temperaturës, magazinimi	° C	(-15 deri + 65	
Lagështira relative (pa kondensim)		maks. 95 %	
Dimensionet orientuese (LxWxH)	mm	225 x 295 x 85	
<b>Siguria</b>			
Klasa IP sipas standartit EN 60529		IP30	
Markimi CE		Po	
Klasa e mbrojtjes sipas standartit EN 61140		II	
<b>Referencat</b>			
Mënyrat e matjes		2WA/2WR/2WAP 3WA/3WR/3WAP/3WRCA/3WRCB 4WA/4WAb/4WR/4WRb/4 WAP/4 WAPb /4WRC	
Fundamental frequency	Hz	15 deri 70	
Gjerësia e bandës	Hz	3000 Hz	
Klasa e saktësisë për matjen e fuqisë/energjisë		0.1	
Saktësia e matjes së këndit		< 0.015° [ $< 0.1^\circ$ ]	
Matja e devijimit të Frekuencës	Hz	$\pm 0.01$ Hz	
<b>Matja e Tensionit</b>			
Matja e tensionit	V	0.1 V deri 300 V	
Gama e tensionit		250 V, 5 V	
Impedanca hyrese e kanaleve të tensionit (ne diapazon)		245 k $\Omega$ @ 250 V	

		10 M $\Omega$ @ 5 V	
Saktësia e matjes së tensionit		< 0.05 % @ 30V .. 300 V < 0.2 % @ 500 m V .. < 30 V < 1 % @ 100 m V .. < 500 m V	
<b>Matja e rrymës</b>			
Matja e rrymës	A	0.001 deri 12 A	
Gama e rrymës		10 A, 5 A, 2.5 A, 1 A, 500 m A, 250 m A, 100 m A, 50 m A	
Gama e përdorimit		10 ... 120 %	
Impedanca hyrëse e kanaleve të rrymës (në diapazon)		~ 40 m $\Omega$ @ 50 m A .. 10 A	
Saktësia e matjes së rrymës		< 0.05 % @ 10 m A ... 12 A < 0.20 % @ 5 m A ... < 10 m A [< 0.3 % @ 100 m A ... < 500 m A]	
<b>Matja e Energjisë</b>			
Saktësia e matjes e fuqisë/energjisë		< 0.1 % @ 10 m A ... 12 A	

## 1.2. - 8. APARAT PËR MATJEN E REZISTENCËS SË TOKËS

Aparati i tokëzimit duhet të jetë instrument i fortë dhe kompakt i projektuar për matjen e rezistencës së tokës. Aparati duhet të ofroj teknikën e testimit me darë, i cili thjeshton testimin e rrjetës së tokëzimit dhe mundëson matjen e rrymës e rrjedhjes jo ndërhyrese pa prishur qarkun.

Aparati për matjen e rezistencës së tokës kërkohet për të matur Rezistencën e Tokës për kushtet si në vijim:

- Matje të rezistencës së tokës në situata të vështira, ku zhurma është prezente në tokë.
- Matje të rezistencës së tokës për sisteme të mëdha komplekse tokëzimi.
- Të masë rrymën e rrjedhjes së tokës, nga 0,2 mA në 1000 mA, pa pasur nevojë të shkëputet
- Të masë rrymën AC nga 0,2 A në 30 A
- Saktësi matje të rezistencës së tokës në nënstacione ku ndryshimi i vlerave të tokës
- do të jetë i madh.

Karakteristika të tjera :

- Të ketë një hapje të madhe të nofullës, për testimin e përcjellësave në tokë dhe të zbarave ekuipotenciale.
- Të ketë kufij alarmi Të lartë/Të ulët që mund të përcaktohen nga përdoruesi për vleresimin e shpejt në matje.
- Të ketë një buton për mbajtjen e të dhënave në ekran për të kapur leximet në vende që janë të vështira për tu arritur.
- Të regjistroj automatikisht vlerat e matura.
- Të ofroj vetëkalibrim automatik për të siguruar matje të sakta.
- Të ofroj mbrojtje nga mbingarkesa deri në 200 A.

## TABELA E TË DHËNAVE TEKNIKE

### SPECIFIKIMET TEKNIKE

<b>APARAT PËR MATJEN E REZISTENCËS SË TOKËS</b>			
<b>PËRSHKRIMI</b>	<b>Njësia</b>	<b>KËRKOHET</b>	<b>Ofrohet</b>
Gama e temperaturës së magazinimit	°C	-20°C to 60°C	
Lagështira e magazinimit	< 75% Rh	< 75% Rh	
Lagëshira e operimit	Rh	< 85%	
Ekрани		999 Ekran Dixhital LCD me simbole speciale	
Protection		IP30 sipas IEC 529/EN 60529	
Siguria		300 V, shkalla e ndotjes 2 IEC 61010-1 dhe IEC 61010-2-032	
Seksioni I përcjellësit	mm	35 (afersisht)	
Dimensioni (LxWxD)	mm	280 x 100 x 50 mm	
Emetimi		IEC 1000 4-2, IEC 61326-I class B	
Imuniteti		IEC 61000-4-2, 8 kV(ajër) kriteri A IEC 61000-4-3, 3 V/m Kriter performancë A	
Gama e përzgjedhjes		Auto	
Koha e matjes	s	1	
Frekuenca e matjes	kHz	3.333	
Jetëgjatësia e baterisë	orë	≥ 8 (operim i vazhdueshëm)	
Konsumi	mA	4	
Tregues i baterisë		Simbol në ekran	

## 1.2. - 9. MULTIMETËR INDUSTRIAL

Multimetri duhet të jetë prej një materiali shumë të fortë që të jetë i përshtatshëm për përdorim në terren. Multimetri duhet të jetë i pajisur me darë rryme deri në 400A, për të ofruar rezolucion dhe saktësi për të zgjidhur në menyrë efikase problemet e çdo sistemi elektrik.

Multimetri duhet të ketë funksionet si në vijim:

- Saktësi mbi vlerat efektive me rang automatik dhe manual, Display Hold, Auto Hold dhe të rregjistroj vlerat Minimale/Maksimale-Mesatare.
- Darët e rrymës të ofrojnë saktësi matje deri në 400 A AC pa prishur qarqet elektrike.
- Të ofroj mundësi për të berë matje në menyrë të sigurt me vlerësimet standarte të sigurisë industriale.
- Të jetë i paisur me të gjitha asetet e përdorimit si fisha kablllo, varëse magnetike.

### TABELA E TË DHËNAVE TEKNIKE

<b>SPECIFIKIMET TEKNIKE MULTIMETËR INDUSTRIAL</b>
---

PËRSHKRIMI		Njësia	KËRKOHET	Ofrohet
Tensioni DC	<b>Tensioni Maksimal</b>	V	1000	
	Saktësia		$\pm(0.05\% + 1)$	
	Rezolucioni Maksimal	$\mu\text{V}$	10	
Tensioni AC	<b>Tensioni Maksimal</b>	V	1000	
	Saktësia		$\pm(0.7\% + 2)$ vlera e RMS	
	Gjerësia e bandës AC		20 kHz me filter kalimi të ulët; 3 dB @ 1 kHz	
	Rezolucioni Maksimal	mV	0.1	
Rryma DC	<b>Rryma Maksimale</b>	A	10 A (20 A per 30 sekonda maksimumi)	
	Saktësia		$\pm(0.2\% + 2)$	
	Rezolucioni Maksimal	$\mu\text{A}$	0.01	
Rryma AC	<b>Rryma Maksimale</b>	A	10 A (20 A per 30 sekonda maksimumi)	
	Saktësia		$\pm(1.0\% + 2)$ vlera e RMS	
	Rezolucioni Maksimal	$\mu\text{A}$	0.1	
Rezistenca	<b>Rezistenca Maksimale</b>	M $\Omega$	50	
	Saktësia		$\pm(0.2\% + 1)$	
	Rezolucioni Maksimal	$\Omega$	0.1	
Kapaciteti	<b>Kapaciteti Maksimal</b>	$\mu\text{F}$	9,999	
	Saktësia		$\pm(1\% + 2)$	
	Rezolucioni Maksimal	nF	0.01	
Frekuenca	<b>Frekuenca Maksimale</b>	kHz	200	
	Saktësia		$\pm(0.005\% + 1)$	
	Rezolucioni Maksimal	Hz	0.01	
Cikli i punës	<b>Cikli i punës maksimale</b>		99.90%	
	Saktësia		$\pm(0.2\% \text{ per kHz} + 0.1\%)$	
	Rezolucioni Maksimal		0.10%	
Matja e temperaturës		$^{\circ}\text{C}$	$-200.0^{\circ}\text{C} - 1090^{\circ}\text{C}$	
			duke përfshirë sondën	
Përcjellshmëria	<b>Përcjellshmëria Maksimale</b>	nS	60	
	Saktësia	$\pm(1.0\% + 10)$	$\pm(1.0\% + 10)$	
	Rezolucioni Maksimal	nS	0.01	
Dioda	<b>Diapazoni</b>	V	3	
	Rezolucioni	mV	1	
	Saktësia		$\pm(2\% + 1)$	
Gama i ciklit të punës	<b>Saktësia</b>		Brënda $\pm(0.2\% \text{ per kHz} + 0.1\%)$	
<b>Kushtet e mjedisit</b>				
Temperatura e punës		$^{\circ}\text{C}$	$-20^{\circ}\text{C}$ deri $+55^{\circ}\text{C}$	



Temperatura e magazinimit	°C	-40 °C deri + 60 °C	
Lagështia (pa kondensim)		0% – 90% (0 °C – 35 °C)	
		0% – 70% (35 °C – 55 °C)	
Lartësia	m	2000	
<b>Specifikimet e sigurise</b>			
Kategoria e mbitensionit	V	EN 61010–1 deri 1000 V	
<b>Specifikimet per daret e rrymes</b>			
Rryma Nominale	A	400	
Gama e vazhdueshme e rrymës	A	1 A - 400 A	
Rryma maksimale jo shkatërruese	A	1000	
Rryma më e ulët e matjes	A	1	
Saktësia		2% + 0.06 A	
		(45-400 Hz)	
Frekuenca e përdorshme	Hz	5 Hz - 20 kHz	
Nivelet e daljes	1 mA/A	1 mA/A	
<b>Specifikimet e sigurisë</b>			
Siguria	V	600	
Tensioni maksimal	V	600 V AC rms nga toka, në përputhje me EN61010	

## 1.2. - 10. MODEM KOMUNIKIMI, ME KARTË SIM GSM/GPRS

Modemi i ofruar duhet të jetë pajisje inteligjente e cila duhet të lidhet me matësat e energjisë nëpërmjet portës së komunikimit me matësin, i cili do të mbledhë të dhënat e mëposhtme të konfiguruar sipas kërkesës.

Të gjitha të dhënat e regjistruara në matës (orare/ditore/javore/mujore)

- Parametrat e çastit.
- Te dhënat e faturimit të momentit (billing) dhe ato të muajve të kaluar (sic janë regjistruar në matës)
- Profilet e regjistrimit
- Të dhënat e ndërhyrjeve, parametrave

Karakteristikat kryesore

### Ushqimi i modemit

Modemi duhet të jetë në gjendje të punoje me një game tensioni 4.75V deri në 32V.

### Ndërfaqet

Modemi duhet te përputhet me kërkesat e mëposhtme:

1. Ai duhet të operoj me bandë GSM (850/900/1800/1900)
2. GPRS Klasa 10
3. Duhet të jetë i pajisur me indicator LED
4. Ndërfaqja e SIM duhet të jetë 1.8V/3V

### Përputhshmëritë

- Të jetë në përputhje me standardin RoHS (2002/95/EC Directive)
- Të ketë markën CE

### Memoria

- Modemi duhet të ketë memorie flash të paktën 1.5 MB
- Modemi duhet të ketë memorie RAM : 256 KBytes

### Mjedisi

- Kushtet e punës -30°C deri +75°C

- 
- Lagështira Relative : Deri në 90% jo kondensues për 30 ditë

#### **Programimi (Software)**

- Modemi duhet të japë mundësinë e zhvillimit, testimit, korigjimit, shkarkimit dhe të ekzekutoj aplikim të shkruar në standardin ANSI C
- Të ofroj Internet Services si : HTTP, FTP, POP3, DNS, MMS, SMTP
- Të ofroj TCP/IP : UDP, TCP

#### **1.2. - 11. VULA PLASTIKE ME LOGO OST SH.A.**

- Vulat plastike duhet të përgatiten me material special i cili të siguroj që vula të mos hapet në temperaturë nga -10°C deri në 120°C, apo si alternativë tjetër vula të jetë e dëmtueshme në mënyrë të pakthyeshme për ato temperatura. Vula nuk duhet të hapet as me mjete të tjera speciale pa u dëmtuar në rast se bëhen përpjekje për manipulimin e vulës me qëllim vjedhjeje të energjisë elektrike.
- Vula plastike dhe ngjyra e saj duhet të jetë e qëndrueshme ndaj kushteve klimaterike dhe agjentëve atmosferikë.
- Mekanizmi mbylles së vulës duhet të jetë me çikrik dhe veshi i vulës pas mbylljes të jetë lehtësisht i këputshëm.
- Vulat plastike duhet të kenë të shkruajtura numrin e serisë me 6 shifra dhe emri “OST sh.a” në relief të shkruar me lazer.
- Pjesa e brëndshme e vulës duhet të jetë e kuqe.
- Pjesa e jashtme e vulës duhet të jetë i tejdukshëm.
- Çdo vulë të shoqërohet me 0.4 ml tel të viaskuar i cili duhet të jetë lehtësisht i përkulshëm, i paoksidueshëm dhe të ketë thellësi viaske të mjaftueshme për mosshkëputjen e tij nga vula edhe për temperatura të larta, hapi i viaske  $\leq 3\text{mm}$  dhe diametri i telit  $\leq 0.8\text{mm}$ .
- Vulat të paketohen në kuti ose qese me 100 copë për kuti ose qeskë ku të ruhet renditja e numrit të serisë dhe të jenë shënuar nga : 008501,010500).
- Teli i viaskuar të paketohet me rokela (bobina) me gjatësi 1000 ml.

#### **Shënime:**

- i. Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.**
- ii. Kudo ne Specifikimet Teknike ku janë cituar standarde nderkombetare, do te pranohen edhe cilësime ekuivalente nga një institut vendor.**

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

## FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

**Sasia e mallit që kërkohet:**

Nr.	Pershkrimi i mallrave	Njesia	Sasia
1	Matës inteligjent energjie 0.5S/5A	copë	50
2	Matës inteligjent energjie 0.5S/1A	copë	30
3	Matës inteligjent energjie 0.2S/5A	copë	20
4	Matës inteligjent energjie 0.2S/1A	copë	20
5	Konverter TCP/IP	copë	20
6	Boks hermetik matje	copë	25
7	Stendë Etalon Testues Portativ Matësi	copë	1
8	Aparat për matjen e rezizstencës së tokës	copë	1
9	Multimetër industrial	copë	2
10	Modem komunikimi, me kartë SIM GSM/GPRS	copë	50
11	Vula plastike me logo OST sh.a.	copë	2,000

**Afatet e lëvrimit:**

6 (gjashtë) muaj nga hyrja ne fuqi e kontrates

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1.	Te gjithë mallrat objekt procedure prokurimi, sipas pershkrimit te bere ne Specifikimet Teknike (Shtojca 5)		OST sh.a.	6 (gjashtë) muaj nga hyrja ne fuqi e kontratës

---

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

## **FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
